



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 27/2011
Prishtinë, më 01.09.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha - Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Ramiz Kelmendi, Biserka Kostiq dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi- ZPRK; Frymëzim Isufaj dhe Hakif Jashari –MZHE; Haxhi Gashi dhe Kreshnike Kurtishi USAID/Deloitte; Reshat Fetahu, Maurice Doëney – AKP; Besim Zeqiri - ICO; Sanije Berisha - OSBE dhe Natyra Kasumaj- KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Brikena Hoxha, konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.08.2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.08.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 25.08.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;

Kryetari - Tha se ne e kemi trajtuar këtë projektligj dhe vërejtje substanciale nuk ka pasur, përveç disa që janë më tepër të karakterit gjuhësor dhe teknik. Prandaj propozoj që të fillohet nen për nen të shqyrtohet Projektligji.

Lutfi Zharku – Në emër të Grupit parlamentar të LDK- së kërkoi që në fund të Projektligjit të këtë një amendament ku thuhet se “ky ligj nuk trajton çështjen e Kompleksit Trepça”, sepse duhet të ketë ligj të veçantë për ta rregulluar këtë çështje.

Reshat Fetahu (Agjencia Kosovare e Privatizimit) - Tha se ky projektligj është për Trepçën, por trajton edhe çështjen e ndërmarrjeve që janë me karakter strategjik. Ky projektligj, AKP- së, ia lehtëson punën për pjesën e ndërmarrjeve të mbetura pa u privatizuar dhe është lidhur më punën e dy projektligjeve për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Projektligjin për AKP- në.

Myzjene Selmani – Tha se nga titulli i Projektligjit po kuptohet se ka mundësi të riorganizohen edhe ndërmarrjet e tjera. Dhe siç dihet deri tani ka qenë një rregullore e UNMK-ut, që është punuar deri më tani dhe më e mira, tani duhet të zëvendësohet me aprovimin e këtij projektligji, dhe esencialisht duhet të ketë edhe një projektligj të posaçëm për Trepçën.

Sala Berisha – Shala - Tha se ne, si Komision, duhet ta përfundojmë këtë projektligj, sepse me miratimin e këtij projektligji ne ju hapim rrugë për t’i rregulluar çështjet e pazgjidhura të disa ndërmarrjeve që kanë mbetur pa titullar. Qëllimi është të zhbllokohet ky proces, ndërsa Trepça është nën moratoriumin e Qeverisë dhe nuk mund të nxjerrët Ligji për Trepçën.

Visar Ymeri - Theksoi se ky projektligj në esencë rregullon çështjen e Trepçës, edhe pse nuk e ka emërtuar sponsoruezin. Kishte disa vërejtje që kanë të bëjnë me funksionimin e Trepçës, lidhur më çështjen e Administratorit rreth menaxhimit, sepse i lihet hapësirë e madhe e kompetencave edhe mos dhënie e llogarisë për veprimet e tij, qofshin të dëmshme në raport me kreditorët. Prandaj, për këtë është më mirë që kreditorë të jetë edhe Qeveria. Shtoj me tej se çështja e xeheve metalurgjike të mos jetë në kuadër të ndërmarrjes Trepça, por në këtë industri duhet të investojë Qeveria dhe të mbesin ndërmarrje publike ose shtetërore, sepse kapitali privat është parë nga përvoja e shteteve të tjera, që në këtë industri të mos ketë sukses, si p.sh. tani në Angli shteti e ka këtë industri si pasuri kombëtare.

Berat Buzhala - Tha se kjo hapësirë që i jepet administratorit është që të mos punohet nën presion dhe të menaxhohet më mirë, dhe nëse ndodh që ka shkelje gjatë ushtrimit të detyrës, si administrator, ai duhet të japë përgjegjësi.

Kryetari kërkoi nga njësia mbështetëse e Komisionit që të hartojë në formë të amendamenteve çështjet e hapura, çështjet e diskutueshme që dolën nga debati dhe të bëhet një harmonizim i gjuhës shqipe me atë angleze, dhe pastaj të vendosën në një tabelë krahasuese dhe t'i sjellët Komisionit për shqyrtim.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet mbledhja për shkak të nevojës së harmonizimit të qëndrimeve dhe rregullimit të aspektit gjuhësor të Projektligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit